



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË
SHTYPSHKRONJA E LETRAVE ME VLERË SH.A

Nr 3 Prot

Datë : 04/01/2023

KONTRATË QIRAJE
Qiraje për Periudhën 02.01.2023 - 02.01.2024

Palët :

QIRADHËNËSI

Shoqërisë "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" SH.A., regjistruar pranë QKR-së, me NIPT: J61827076U me seli në adresën , Rruga "Xhanfize Keko" Tiranë, përfaqësuar nga Administratori i ar si " Qiradhënësi " .

QIRAMARRËSI

Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë, regjistruar në QKB me NIPT : K61809004 , me seli në adresën, Rruga "Xhanfize Keko" Tiranë, përfaqësuar nga A e quajtur si "Qiramarrës".

Neni 1

OBJEKTI I KONTRATËS

1. Rregullimi juridik i marrëdhënies kontraktuale Qiramarrës- Qiradhënës për përdorimin e ambjenteve me sipërfaqe **197 m²** që ndodhen në Territorin e Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sha) , ku qëllimi i përdorimit nga Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë është për ushtrimin e verpimtarisë së tyre (zyra) .

Neni 2

BAZA LIGJORE

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë , neni 801 në vijim ,
- Ligji nr.,9901 datë 14.04.2008 " Ligji per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar
- VKM-në Nr. 54, datë 05/02/2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore"i ndryshuar .

Shtypshkronja e Letrave me Vlere sha , Rruga " Xhanfize Keko" ish Tipografia Ushtarake ,Tiranë .

NENI 3

KOHËZGJATJA E KONTRATËS

- Kjo kontratë lidhet me një afat 1 (një) vjeçar që përfshin periudhën nga data 02.01.2023 deri më 02.01.2024
- Me pëlqimin reciprok të dy palëve mund të bëhet rinovimi i kontratës së qirasë pas mbarimit të afatit të përcaktuar .
- Për rinovimin e kontratës , pala e interesuar qiramarrësi duhet që të bëjë kërkesën me shkrim .

NENI 4

PAGESA

- Qiramarrësi do ti paguajë qiradhënësit shumën mujore prej [REDACTED]
- Pagesa do të kryhet cdo datë 5 të muajit pasardhës, në llogarinë e shoqërisë “ Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sha .
- Në rast se qiramarrësi nuk bën pagesën e qirasë në afatin e caktuar të parashikuar në këtë kontratë ai detyrohet të paguajë 0.1% të shumës së qerasë mujore për cdo ditë vonesë.

NENI 5

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRAMARRËSIT

- Të marë në dorëzim sendin dhe ta përdorë sipas qëllimit të përcaktuar në kontratë
- Qiramarrësi ka të drejtën e përdorimit të ambjenteve të përbashkëta duke e përdorur për të parkuar gjithësej 5 automjete, sipas listës së targave që gjendet në Aneksin 1, bashkëngjitur kësaj kontrate.
- Ambjenti që është në përdorim të qiramarrësit do të ruhet nga Sherbim i ruajtjes dhe sigurise fizike me roje private te godinës dhe ambienteve rrethuese të institucionit , të cilat paguhen nga qiradhënësi .
- Qiramarrësi nuk ka të drejtë të japë objektin me nënqira.
- Qiradhënësi nuk ka detyrim ligjor për kryerjen e riparimeve të objektit , cdo riparim I nevojshëm është e drejta dhe detyrimi i qiramarrësit.

NENI 6

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRADHËNËSIT

- Qiradhënësi duhet që të ti dorëzojë qiramarrësit ambjentin sipas qëllimit të përcaktuar në këtë kontratë
- Të garantojë gëzimin e qetë përgjatë periudhës së qirasë
- I garanton ruajtjen dhe sigurinë fizike të ambjenteve që kanë në përdorim

Shtypshkronja e Letrave me Vlere sha , Rruga “ Xhanfize Keko” ish Tipografia Ushtarake , Tiranë .

- Qiradhënësi dorëzon objektin e dhënë me qera në gjendjen që ndodhet aktualisht
- Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër në këtë kontratë duke e njoftuar këtë të fundit 15 ditë përpara me shkrim.

NENI 7

ZGJIDHJA E KONTRATËS

Kjo kontratë zgjidhet para afatit në këto raste:

1. Kur objekti kalon për privatizim
2. Kur qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër
3. Nuk përdor objektin për qëllimin e marrë
4. Kur ndryshon destinacionin e objektit të kontratës

NENI 8

DISPOZITA TË PËRBASHKËTA

- Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin midis palëve në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj kontrate do të zgjidhen me mirëkuptimin midis tyre , në të kundërt organi kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjygjësor Tiranë .
- Kjo kontratë hartohet në 4 kopje , ku palët marrin nga dy kopje .

PALET

**SHTYPSHKRONJA E LETRAVE
VLERË SHA**

Besmir HYSA

**URDHRI I FARMACISTËVE
TË SHQIPËRISË**



Diana TOMA